



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I DËGJIMIT PUBLIK NË KOMISIONIN PËR ZHVILLIM EKONOMIK, ...
MBAJTUR MË 4. 4. 2018

SA JAVNE RASPRAVE U KOMISIJI ZA EKONOMSKI RAZVOJ, ...
ODRŽANA 04. 04. 2018. GODINE

PRILL / APRIL
2018

Mbledhjen e drejtoi kryesuesja e grupit punues, znj. Mimoza Kusari-Lila

Dëgjim publik për Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit

KRYESUESJA: Faleminderit që pozitivisht i jeni përgjigjur ftesës për të qenë bashkë në dëgjimin publik për Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Jam Mimoza Kusari-Lila, deputete në Kuvendin e Kosovës, përndryshe kryesuese e grupit punues për këtë projektligj.

Ky projektligj ka ardhur si një prej projektligjeve tepër të rëndësishme për mbrojtjen e konsumatorit por gjithashtu edhe për domosdoshmërinë që është nxjerr në raport ose gjatë periudhës së funksionimit të ligjit paraprak, mangësive të cilat janë evidentua dhe domosdoshmëri për t'u mbulua disa sfera të rëndësishme në mbrojtjen e konsumatorit në Republikën e Kosovës.

Sot diskutimi do të jetë i tërë në raport me nenet, dispozitat e këtij projektligji dhe unë ju falënderoj të gjithë ata që deri më tash keni kontribuar në draftimin apo në komentet në fazën kur ka qenë në përgatitje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë para se t'i vijë Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

Megjithatë më duhet gjithashtu të potencoj se gjithë ju që keni komente ato të cilat do t'i flisni këtu do të incizohen do të thotë mbledhja është e incizuar dhe do të jetë një transkript detaj i mbledhjes në mënyrë që secilit vërejtjet dhe sugjerimet të merren parasysh nga Komisioni Parlamentar por gjithashtu edhe ju që e ndjeni nevojën që këto komente t'i përcillni pastaj me shkrim.

Ju kisha lutë për informatën e juaj prej fillimit po ju tregojmë se komentet me shkrim në kuadër të amendamenteve shtesë ose plotësimeve në projektligj i pranojmë deri të premten më 6 prill, do të thotë komentet me shkrim duhet të dorëzohen pranë Sekretarisë së Komisionit për Zhvillim Ekonomik deri ditën e premte gjegjësisht fundin e kësaj jave.

Ky dëgjim është bërë që të merren të gjitha sugjerimet nga palët e interesit.

Unë do hapë menjëherë diskutimin. Ju lus që përkundër faktit që ne mund të njihemi që edhe zyrtarisht për procesverbal të prezantoheni emrin dhe institucionin që ju përfaqësoni.

Ju kisha dhënë fjalën fillimisht institucioneve të cilat janë këtu prezentë natyrisht përfaqësuesve të tyre nëse duan që të japin komentet e tyre lidhur me projektligjin dhe pastaj natyrisht gjithë tjerëve që janë prezent këtu në takim.

Ju faleminderit edhe një herë për prezencën tuaj dhe e hap këtë diskutim publik për Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Kush e dëshiron fjalën?

RAIF PRETENI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Unë jam Raif Preteni, drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit.

Bazuar në vështirësitë e identifikuar në praktikë në zbatim të nenit 29 të ligjit aktual po edhe tash të nenit 25 rreth faturimit të shërbimeve publike, në theks të veçantë në faturimin e konsumatorëve në ndërtesat e banimit kolektiv të cilët për shërbime e marra të ujësjellësit faturohen përmes ujëmatësit të përbashkët.

I lutemi Komisionit që me Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit të përfshijë edhe një nën paragraf me qëllim që të krijohet baza ligjore për faturimin e kësaj kategorie të konsumatorëve.

Po e lexoj, propozimi jonë: “Faturimi i ujit për rastet kur konsumatori në ndërtesat e banimit kolektiv në ujëmatës të përbashkët nuk e përmbushin obligimet për vendosjen e njëisorit individual të bëhet sipas akteve të nxjerra nga autoriteti rregullator për shërbimet e ujit”.

Propozimi i referohet gjendjes aktuale të kategorisë së konsumatorit të cilët banojnë në ndërtesat e banimit kolektiv të ndërtuara para vitit 1999 në ujëmatës të përbashkët, mbështeten me fakte ... si në vijim.

Në rajonin e Kosovës aktualisht janë 1350 ndërtesa të banimit kolektiv me ujëmatës të përbashkët. Edhe pse një numër i konsumatorit të këtyre ndërtesave kanë vendosur ujëmatës individual janë rreth 19 mijë konsumatorë në Kosovë të cilët për arsye të ndryshme nuk dëshirojnë të vendosin ujëmatësin individual dhe aktualisht faturohen përmes ujëmatësit të përbashkët.

Vetëm në rajonin e Prishtinës janë rreth 15 mijë konsumatorë pa matës individual të cilët faturohen përmes ujëmatësit të përbashkët.

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit dhe ofruesit e shërbimeve nuk kanë mekanizma .. ligjor për të detyruar këta konsumator të instalojnë ujëmatësin individual

Shkycjet individuale të konsumatorëve të cilët refuzojnë të instalojnë ujëmatësin individual janë teknikisht të pamundshme për shkak të natyrës dhe rrjetit të ujësjellësit në këto ndërtesa.

Shkyçjet kolektive janë të papranueshme duke e parë parasysh se në kuadër të këtyre ndërtesave ka konsumatorë të cilët kanë përmbushur obligimin për vendosjen e ujëmatësve individual.

Mos përfshirja e këtij propozimi dhe aplikimi vetëm i një paragrafi një të këtij neni nënkupton mos faturimin e konsumatorit të cilët nuk përmbushin obligimin për vendosjen e ujëmatësit individual.

Nga një analizë e bërë nga rajoni i Prishtinës ka rezultuar se mos faturimi i këtyre konsumatorëve do të ndikoj në rritjen e tarifës aktuale të ujit për afër 10% që do të thotë që konsumatorët e ndërgjegjshëm do të paguajnë tarifë më të lartë.

Nga të gjitha faktet e përmendura më lartë konsiderojmë se është më se e nevojshme të rregullohet mundësia e faturimit të këtyre konsumatorëve përmes akteve nënligjore të nxjerrë nga RU.

Shpresojmë që ky propozim të merret parasysh nga grupi punues dhe Komisioni respektiv. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Preteni!

Për komentet, për sugjerimet edhe vlerësimet e dhënë unë gjithashtu ju kërkoj ashtu siç e kërkoja në fillim që këto komente të cilat ju i lexuat bashkë me vlerësimet t'i përcjellini me shkrim. Faleminderit!

Dikush tjetër?

DREN AJETI: Përshëndetje,

Unë jam Dren Ajeti, nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës.

Ne komentet tona i kemi dërguar vetëm me shkrim por me qëllim që edhe t'i mbrojmë publikisht sot po paraqes propozimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës që në Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorëve të përfshihet edhe një dispozitë ligjore gjegjësisht neni 16, paragrafi 7 do të thotë t'i shtohet një paragraf i ri me numrin 8, ku thuhet "se përveç kërkesave të përcaktuara me nenin 16 shitësi detyrohet të tregoj origjinë e produktit edhe përmes vendosjes të një etikete në çmimoren do të thotë në pjesën e çmimit të produktit.

Arsyeja e kësaj do të qëndron në atë që sipas nenit 4 të nën-paragrafit 1.2 të projektligjit konsumatori e gëzon të drejtën e informimit me produktin.

Më saktësisht projektligji parasheh etiketimin dhe deklaracionin për prejardhjen e produktit. Mirëpo analizat tona kanë tregua që vetëm një numër shumë i vogël i qytetarëve e kërkojnë

informacionin mbi .. e produktit dhe si arsye do të thotë që ata e kanë përmendur është edhe mundimi që gjatë gjetjes së shënimit mbi prejardhjen e produktit.

Pra shumë qytetarë nuk janë të vetëdijshëm që anash produkti ekziston edhe prejardhjen nga vjen ky produkt.

Prandaj, ne mendojmë që shënjimi i produktit përmes një flamuri tek çmimorja kish me ndihmua që qytetarët e Kosovës të jenë të informuar mbi prejardhjen e produktit.

Një praktikë e tillë do të thotë edhe në vendet e tjera siç është për shembull Maqedonia, Franca, Anglia apo Austria.

Unë këtu i kam marrë vetëm dy fotografi të cilët janë bërë nga qytetarët e Kosovës në Austri ku mund të shihet këtu tek pjesa e çmimit është e vendosur edhe flamuri. Kjo do të thotë e ka për qëllim që të informojë qytetarët e Kosovës se nga po vjen ai produkt dhe qytetarët e Kosovës të jenë të informuar se produkti të cilin ata e konsumojnë a është produkt vendor a është produkt nga rajoni apo është produkt edhe nga vendet e Bashkimit evropian.

Siç thash analizat tona e kanë tregua që vetëm një numër shumë i vogël i qytetarëve të Kosovës janë të informuar mbi prejardhjen e produktit dhe ne përmes propozimit tonë synojmë që qytetarëve t'ua lehtësojmë të drejtën e tyre për informim gjegjësisht të drejtën e tyre që të jenë të informuar mbi prejardhjen e produkteve të cilët ne i konsumojmë çdo ditë.

Siç e ceka edhe më herët ne komentet i kemi dërgua në Komisionin për Zhvillim Ekonomik po nëse është nevoja i dërgojmë prapë.

Dhe natyrisht e paraqes edhe kërkesën në rast se nuk paraqet ndonjë problem për Komisionin që të jemi edhe pjesë e grupit punues nëse diçka e tillë nuk shihet si problematik nga ana e grupit punues. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit!

Dy komente, sa i përket flamurit mendoj drejtë legjitime secili domethënë më shumë informacione për secilin produkt është më mirë dhe benefit edhe të vetë konsumatorit.

Në anën tjetër në aspektin politik në Kosovë dom me i pas dy flamuj të Shqipërisë dhe të Kosovës për me ditë se, ka njerëz në Kosovë që jetojnë që flamuri i Kosovës nuk i tërheq a produkti po i kthen mbrapa. Kështu që edhe me tregua prejardhjen e origjinës.

Sa i përket pjesëmarrjes në grup punues pa asnjë problem, domethënë grupi punues është grup punues i hapur, ka mundësi të pjesëmarrjes, të komenteve. Natyrisht kur vjen puna e votimit janë

vetëm deputetët e Kuvendit që kanë të drejtë votës por ne jemi të hapur mund të ju lajmërojmë, të ju informojmë jo vetëm juve po edhe të tjerët që kanë interes në momentin kur fillon diskutimi dhe trajtimi i neneve dhe propozimeve sot që epen që të jeni prezent aty dhe të jeni pjesë e atij debati por jo vendimmarrje se nënkuptohet që në parlament ekziston një procedurë për votim në kuadër të komisioneve funksionale.

Dikush tjetër.

BERAT THAÇI: Përshëndetje, unë jam Berat Thaçi, nga Instituti GAP.

Vetëm e cekim fillimisht që Instituti GAP nuk është i specializuar në monitorimin apo në çështjet e konsumatorit. Mirëpo gjatë punës tonë kemi hasur një problem.

Problemi ka të bëjë me aktet nënligjore që miratohen nga ministrinë edhe çka ndodhë nëse një ministri do të thotë e miraton një akt nënligjor i cili është në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Pra, ka një mungesë të mekanizmit që kishte me siguria që vetë institucioni dizajnon shërbimet për qytetarë apo politika publike të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

Konkretisht udhëzimi administrativ që ka pasur të bëjë me homologim e ka mohua të drejtën e qytetarëve për zgjedhjen e shërbimit. Pra në rastin e homologimit të veturës në Kosovë je i obliguar që kontrollin e parë teknike me krye te institucioni i cili e homologon veturën edhe kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 51, pika 1.18 e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Pra, e mohon lirinë e zgjedhjes së konsumatorit edhe kjo është liri fundamentale e zgjedhjes.

Ne e kemi një institucion në Ministrinë e Tregtisë i cili në rast si qytetar ankohesh ata reagojnë për çështjet e konsumatorit mirëpo çka nëse institucioni vetë ka dizajnuar politika të cilat nuk e lejojnë lirinë e zgjedhjes dhe për këtë arsye ne konsiderojmë që është me rëndësi që të krijohet një mekanizëm apo një nen në pjesë të këtij ligji i cili i detyron të gjitha institucionet publike që në rastet kur miratojnë akte nënligjore të cilat e prekin shërbimin ndaj qytetarëve apo këtë ligj ato institucione duhet të detyrohen ta konsultojnë departamentin përkatës në Ministrinë e Tregtisë.

Ky është pra problemi specifik që e kemi pa në raport me këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Njazi Shala.

NJAZI SHALA: Berat me këtë rast për projektligj apo për ligjin aktual.

BERAT THAÇI: Po mendoj çfarëdo mekanizmi...

NJAZI SHALA: Jo se kur the neni 51 ligjit aktual apo projektligjit

BERAT THAÇI: Jo ligjit aktual, mundet mos me qenë specifik po në parim ky është problemi, çka nëse një institucion miraton akt nënligjor që është në kundërshtim me këtë ligj, a konsultoheni ju si MTI, nuk kemi pa ne që ka një mekanizëm të tillë.

Mekanizëm i ngjashëm i konsultimit kemi pa te Ligji për shërbime, e kanë draftua një udhëzim administrativ që i obligon institucionit publike me u konsultua autoritetet përkatëse kur hartojnë shërbime.

Mendojmë që mekanizëm i ngjashëm kishte me qenë funksional apo me zgjidh këtë problem edhe në rastin e çështjes së mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit.

Tash veç një digresion të shkurtë ky udhëzimi i ri administrativ për homologia ende nuk është miratua është në Ministri të Infrastrukturës dhe është institucion që Komisioni e mbikëqyrë, ndoshta kishte me qenë mirë me ja vë mendjen këtij problemi se prapë në udhëzimin e ri administrativ është i njëjti problem. nuk ke mundësi me zgjedh ku e kryen kontrollin e parë teknike të veturës, je i obliguar në një institucion të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rastet e konflikteve të dispozitave ligjore, mes dispozitave ligjore në këtë rast Ligjit të aktit nënligjor i cili mundet me u bë i qëllimshëm apo i rastësishëm, mendoj që nuk mundet një institucion brenda ekzekutivit me e zgjidh, nënkuptohet që parimisht ligji është gjithmonë ai që e mbizotëron udhëzimin administrativ, udhëzimi nuk mundet me qenë më i fuqishëm se sa ligji. Por në raste të tilla të sqarimit duhet drejtua Gjykatës Kushtetuese në mënyrë që të shfuqizohet me një vendim të gjykatës njëra dispozitë ligjore e cila është në kundërshti qoftë që bënë shkelje ligjore apo e cila është në kundërshti me një ligj i cili është ligj që është mbi dispozitën ligjore e cila është miratua dhe është në kundërshtim me ndonjë nen të atij ligjit.

Në këtë rast prej përvojës time institucionale edhe prej sistemit juridik ligji që është ndërtua këtu nuk mundet me u krijuar asnjë entitet brenda ndonjë ministrie ose ndonjë agjencioni tjetër i cili ka me bë interpretim të tillë të dispozitave ligjore apo kundërshtive mes tyre vetëm Gjykata Kushtetuese që e ka mandatin edhe shfuqizimit të menjëhershëm të njëjës për dispozitave ligjore që është në kundërshti me nenet në ligjin e caktuar.

BERAT THAÇI: Diçka e ngjashme është për Ligjin për shërbime është draftua një udhëzim administrativ i cili po e obligon të gjitha institucionet publike që krijojnë shërbime për qytetarë, ata janë të detyruar me konsultua institucionin që e ka draftua ligjin po më duket është MTI-ja

apo MAT-i nuk jam i sigurt, mirëpo e kam pa një praktikë të ngjashme tash në faqen e kryeministrit është udhëzimi administrativ si projekt si draft tu u diskutua.

Kështu që ndoshta ideja është në fazën e draftimit, se normalisht pasi që një institucion e aprovon një udhëzim administrativ sigurisht që institucioni tjetër për shembull MTI-ja nuk mundet me e shfuqizua atë, tani ajo ka mekanizma tjerë.

Mirëpo fazën e draftimit ndoshta sikur me e parandalua këtë fenomen kishte mundë me qenë e detyrueshme me kërkua një .. profesional po jo natyrisht jo e obligueshme, MTI-a nuk mundet me e shfuqizua udhëzime administrative të institucioneve apo ministreve tjera.

Mirëpo, ne çka mundemi me bë besoj që një nen i cili kishte me e obligua kërkimin e vendimit profesional.

NJAZI SHALA: Pasi që veç po bisedojmë për projektligjin është mirë me i evidentua Berat ku, ku saktësisht. Ligji si bazë i ka tri burime e ka ligjin aktual, i ka direktivat dhe ka diçka prej praktikës së punës se na çka. Realisht kjo e treta është pak më e vogël. Po në qoftë se duhet me i parapa saktësisht se ku edhe mandej diskutohet mendoj.

KRYESUESJA: Mendoj se Berati e ceku ligjin aktual shkeljen aktuale që ka ndodhë dhe rekomandimi i tij është që të mos përsëritet ose mos të lejohet me draft-ligjin e ri që me ekzistua kjo hapësirë. Por, problemi nuk ka qenë defekti te ligji burimor i ministrisë së Tregtisë, ka qenë defekti te udhëzimi administrativ i Ministrisë së Infrastrukturës.

Tash në këtë fazë si institucion ose si parlament mundem me kërkua prej ministrit të Infrastrukturës më tutje informacione përmes parlamentit të Kosovës në raport me udhëzimin administrativ po në shkeljet për t'i cilat ti po flet nuk janë aktualisht në ligjin as të vjetrën as draft-ligjin janë në procesin e implementimit domethënë shkelje që ju kanë bë këtij ligji me një udhëzim tjetër të një ministrisë tjetër.

BERAT THAÇI: Ideja e Dhomës pas tash jemi duke diskutua me zotin nga MTI-ja, pasi tash jemi duke diskutua një ligj të ri është moment i mirë për me ulë mundësinë me ndodhë kjo prapë se kjo nuk është 100% që nëse ne e krijojmë një mekanizëm të tillë, nevojën për mendim profesional nga MTI-ja që është marrë, dikush mundet me e qitë prapë në institucion edhe me insistua me atë, tani janë mekanizma tjerë ligjor që i përmendët.

Mirëpo, ne jemi në një moment të mirë me ulë mundësinë me ndodhë propë. Kjo është ideja.

GANI DRESHAJ: Berat, faleminderit!

Mua po më duket po i bien pak rrotull se kjo është direk kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe me kushtetutën.

Ky ligj sa më shpejtë duhet me e dërgua në kushtetuese .. se është gabim se ka mundësinë me u zgjedh.

Nuk e di çka është udhëzimi administrativ po mendoj që ministria e .. e ka më së paku fajin për këtë po kjo është duke u ... qytetari qe sa vjet me këtë ligj i këtij i thonë shqip korrupsion daç hajni qysh donë.

Unë po e di që presionin po ne duhet këtë me heq se nuk ka mundësi që njeri me humb tërë ditën sa herë që e blen një kerr me ja ndryshua ngjyrën edhe me kon i vetmi në Kosovë ajo është monopol i marumë i përgatitur për njerëz.

Të gjithë e dinë se më duket se kemi asnjë parti që nuk u prek prej këtij ligji. Përndryshe duhet me e qua, nëse .. shiqimet teknike në komunën tonë i kemi tri shikime teknike, qyteti i Hamburgu i ka dy shqime teknike me dy milionë e ne në komunën e Istogut i kemi tri.

Domethënë cila ministri ndërrohet ja dhamë nga një shikim teknik si çokollatë ose karamele e njerëzve tanë të partive edhe aty preket e drejta.

Po ky ligji prej që e kam pa unë që është miratua është i keq ne ish dashtë me ja dhënë kryetare ish dashtë me ja dhënë një kohë të përcaktuar edhe investitorit se ai nuk ka faj që ka investua por kjo duhet përfunduar, kjo e keqe njëherë e përgjithmonë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Po zoti Kaçaniku.

SELATIN KAÇANIKU: Faleminderit!

Faleminderit për ftesën, zonja kryesuese

Të nderuar deputetë,

Gazetarë,

Të pranishëm,

Tha kryesuesja me u prezantua, po prezantohem,

Jam Selantin Kaçaniku, ... konsumator në tregun e prodhimeve e mallra dhe shërbime.

Do t'ia marr pakës rolin drejtorit të Departamentit. Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit të Prodhimtarisë me angazhimin maksimal është kujdesur për të hartuar një propozim ligj sa më të kompletuar të mbrojtjes së qytetarëve të konsumatorëve dhe të taksapaguesve, kam nga pak për me mëri me kohë jam mbush frymë.

Ishin risitë në direktivat e BE-së ato që na obliguan ta harmonizojmë Ligjin me 'acquis communautaire' është frëngjisht, dhe me direktivat e BE-së, por gjithmonë ka kërkesa, hapësirë

dhe mundësi për të bërë ligj edhe më të mirë. Arsimi, shëndetësia, rryma, uji, mjedisi, mishi, aditivët, çmimet, faturat na udhëzojnë që të ndjekim trendet e kohës që shfaqet në fushat socio-ekonomike, administrative, juridike, ligjore e politike. Për më pak se një vit e gjysmë prej që projektligji doli nga duart tona tanimë kemi shumë nevoja tjera të kohës, të përvojës, të nevojës ... me kërkesa të reja po në formë të direktivave të BE-së.

Të nderuar deputetë, deputete të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar të pranishëm,

Ja një shembull krejtësisht të ri që e dimë bashkë me drejtorin, është mendim i përgjithshëm e më se i nevojshëm se bërja e ligjeve më të mira, këtë e thashë, domethënë ishte fjala ne ishim në Shkup para dy muajsh dhe atje u trajnuam për të drejtën juridike të kompensimit kolektiv. Domethënë, ajo që ka qenë ka qenë, ne edhe në këtë ligj e kemi paraparë kompensimin, por diqysh pak si me kursim sa për fillim mos me e frikësua askënd, por duhet të bëhemi gati se një epokë e re e Bashkimit Evropian atë që ne po e përmendim për Evropë po vjen.

Unë nuk do të flas shumë, ani se kam shkruar shumë për arsye se pasi kryetarja na tha që duhet t'i procedojmë këto unë dola ... dhe ia kom proceduar para se me na thirr, ju të gjithë i keni deputetët edhe sekretaria e ka materialin. Unë do t'i preki vetëm disa pika, rrethanore që ndikojnë në zbatimin ose moszbatimin e ligjit dhe të ligjeve tjera. Janë mbi 30 ligje që e rregullojnë të drejtën e konsumatorit. Domethënë, Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, ... dhe ministritë me target grup konsumatorë, të cilët i shërbejnë duhet ta pranojnë edhe zbatojnë obligimin e mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile që kujdesen për mbrojtjen e konsumatorëve. Taksapagues i cili nëpërmjet buxhetit të cilin gjeneron, donë kontribut edhe për këtë destinim, edhe për vetveten. Kjo nuk ka ndodh për këto 11 vite prej që ekziston organizata e konsumatorëve.

Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, MTI-ja dhe ministritë me target grup konsumatorë, të cilët i shërbejnë duhet ta përmbushin obligimin administrativë, ligjor e mandator konform këtij ligji, por me dispozitë të veçantë obligative për informimin, arsimimin, edukimin, e vetëdijesimin e qytetarëve konsumatorë për kauzën, për të drejtat dhe obligimet, dhe për interesat e identitetin e tij. Neve po na sulmojnë se s'jemi të vetëdijësuar a e dinë a s'e dinë se e kanë për obligim, por ja që po e them se është obligim i institucioneve për të na vetëdijësuar. Domethënë, nuk mund të ketë ligj as nuk mund të themi që kemi bërë ligj nëse ne nuk jemi të vetëdijshëm se është ligji dhe si ta zbatojmë. Qytetarët, konsumatorët taksapagues me dispozitë të veçantë duhet t'u njihet e drejta e drejtpërdrejtë e matjes së cilësisë së produkteve dhe performansës së shërbimeve, edhe administratës dhe ndërmarrjeve publike.

BE-ja ka nisur aktivitetet e përhapjes këtë që e thashë, tarifa e leximit te njehsorët elektrik na thotë mendja është kërkoj falje për shprehjen "parapagim i ambalazhuar për RTK-në". Këtë e kemi thënë edhe para dy ditësh në një letër të hapur, e pasni marrë. Nuk është asgjë e fshehur,

nuk po flasim pas shpine, ia kemi thënë RTK-së dhe RTK-ja duhet ta dijë se në çdo variant mbështeten nga ne, pra ne duhet të ulemi dhe të bisedojmë. Nuk ka më me shit domethënë duhet t'i drejtohem ... vazhdojnë tendencat e detyrimit të gjyqtarët konsumatorë paguesi i ndershëm të paguajë edhe për ata që me mos pagesën e obligimeve të konsumit nuk e kanë të qartë statusin konsumator. Status ky, të cilin duhet ta caktojë gjykata, enti social ose një dikush tjetër, por kurrësi jo politika.

Nuk dua të ju marr kohë, sekretaria ka mundësi të ua shpërndajë të gjithëve. Faleminderit që më dëgjuat.

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Kaçaniku për kontributin në këtë projektligj edhe në vazhdimësi për ngritjen e vetëdijes të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të drejtën e tyre si konsumatorë.

Është shumë e rëndësishme që përveç miratimit dhe përfshirjes në projektligj të gjitha komenteve të palëve të interesit ndoshta rëndësia më e madhe fillon pas miratimit të projektligjit dhe zbatimit të tij të mirëfilltë. Ndërsa, për dallim prej shumicës së projektligjeve ky është projektligj i cili do të fillojë ose do të ketë zbatim në rast se e ka informimin e mirëfilltë për të drejtat e tyre gjithë konsumatorëve të Republikës së Kosovës. Domethënë, është esenciale që të ketë funksionim të mirë që të gjithë të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe ajo është obligim i gjithë neve qoftë në aspektin institucional, qeveritar, jashtë ose jo qeveritar dhe të prodhuesve dhe kompanive ofruese të shërbimeve.

Dikush tjetër?

SHERIF FEJZULLAHU: Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje deputetë të nderuar, kolegë,

E mora fjalën pas zotit Selatin se jemi në një këshill, jam Sherif Fejzullahu, përndryshe jam kryetar i Këshillit për mbrojtje të konsumatorit në nivel të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe angazhimi im do të jetë paksa jep një kontribut në lidhje me shumë rregulla, të cilat po ndodhin kam punuar një kohë të gjatë në KEK dhe disa praktika të ligjeve kur zgjatin shumë neve si shoqëri po duhet të merremi me pasoja, e përmendët që në fillim dhe kontributi im do të jetë në atë drejtim që duhet të shpejtojmë pak me ligje për arsye se gjithmonë si shoqëri po bëjmë, po merremi me pasoja dhe atëherë tani edhe po na kushton edhe ekonomikisht, politikisht edhe si shoqëri.

Me ju thënë të drejtën kur është fjala te njehsorët elektrik po jua tregoj një praktikë, dikur konsumatorët e energjisë kanë blerë njehsorin elektrik domethënë me para të veta. KEK-u për shembull i ka denoncuar në mënyra të ndryshme duke mos llogarit që nuk është mjet themelor i KEK-ut, për atë arsye nëse neve konsumatori e përmendi zotëria nga shërbimi i ujit, nëse donë

një organizatë ta ketë mjet themelor dhe ta kontrollojë teknikisht dhe mos të lë abuzime duhet të parashohin edhe një investim të një montimi të ... nga vetë organizata, ta regjistrojë si mjet themelor të organizatës dhe sigurisht Hajrizi këto punë i dinë më mirë dhe në afate të caktuara të bëjë kalibrimin, të bëjë kontrollin teknik dhe mos të ndodh që tani të akuzojë konsumatorin. Ju lutem, konsumatori asnjëherë nuk mund ta fitojë kontestin, nuk fitohet me pushtet te organizatat, mos të flasim për shtetin. Edhe organizata ka bërë pushtet, i ka bërë të gjitha institucionet e veta tash me ia nis procedurë duhet shumë investime të mëdha me ardh deri te avokati, deri te ligji.

Edhe çështja tjetër që unë dua të kërkoj nga ju, ju kisha lut që ligji të mos vonohet, përndryshe është ligji aktual ne e kemi një program ... ne do të punojmë në vetëdijesimin e konsumatorit, do ta informojmë konsumatorin, parashihet këtu që në këtë këshill të hyjnë edhe pesë njësi sektoriale, edhe uji, edhe rregullatori i energjisë, edhe Banka Qendrore dhe të bëjmë një këshill autoritativ që ngadalë ngadalë të kalojmë. Dhe çështja tjetër çka unë brengosem, nuk është çështja vetëm, ne në letër dhe në program gjithmonë kemi qenë... i qesim, problemi është te rojet e ligjit, te ata që zbatojnë ligje. Për shembull, një pronarë i një restorani çdoherë, sa herë e prish njehsorin se nëse i merr 3 mijë euro për një natë gjoba ka qenë 350 euro, ashtu është sjell. Domethënë ka llogari çdoherë ta prish njehsorin për t'i fituar 3 mijë euro. Por, një mall nëse hyn në doganë me 20 mijë euro edhe gjobitemi 1 mijë euro po cila është ajo, kush e bën atë.

Për atë arsye ju kisha lut, zonja deputete dhe ju që jeni në krye, kjo shoqëri duhet të ecë përpara me kontrollin e atyre që zbatojnë ligje, me ruajtësit e ligjit. Çka inspektori? Nëse shkon atje ku pihet duhani e sheh është ndaluar, e kanë ndezë të gjithë, e merr e qon ia jep një kaftjall ia lëshon certifikatën edhe u kry puna për gjashtë muaj. Në këtë kuptim ne si shoqatë edhe si këshill do ta japim kontributin tonë, do të ... kërkojmë nga politika dhe nga ligjvënësit të na përkrahin dhe të dalim me të vërtetë si shoqëri e civilizuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Fejzullahu!

Nëse më lejohet vetëm një përvojë ta ndaj me ju, Parlamenti i Republikës së Kosovës përveç mandatit legjislativ natyrisht deputetët e kemi edhe mandatin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit. Deri më tash, edhe zyrtarisht si institucion ndër legjislatura s'po flas për këtë në veçanti gjithmonë kemi çaluar, kemi pas çalime serioze në mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve. Te kjo është një praktikë e përgjithshme e shoqërisë e cila nuk domethënë që duhet me vazhdua, por mundet mu ndryshua.

Dy janë mandatet shtesë përveç draftimit edhe miratimit të ligjeve, mbikëqyrja e Qeverisë edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve. Domethënë, punës së Qeverisë si gardianë të asaj se ekzekutivin çfarë rrugëtimi është. Edhe kjo domethënë s'kam asnjë dyshim që edhe në komisionin ku jemi pjesë unë dhe zoti Dreshaj, por gjithashtu edhe në një shumicë të konsiderueshme të komisioneve ekziston një vullnet shumë i madh në përcjellje dhe zbatim të ligjeve. Ne shumë shpejt do ta kemi edhe agjendën edhe ndarjen e mirëfilltë të deputetëve në mbikëqyrje të ligjeve,

të cilat pastaj ju informojmë se kush do të jetë për cilën pjesë përgjegjës. Ndërsa, për të ua heq merakun juve themi se nuk do të ketë asnjë ndalesë në mbajtje të këtij ligjit.

Domethënë, përveç nëse s'ndodh diçka që është jashtë forcës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, aty s'mundemi me garantu se Kosova është bërë një vend shumë interesant me dinamika politike, ato janë domethënë janë jashtë vendimmarrjes së kësaj salle. Në rrethana tjera normale nëse kemi me qenë mund të ju garantoj që edhe në procedim të ligjit edhe në mbikëqyrje do të keni bashkëpunimin e plotë. Tjetër?

SEJDI HALIMI: Iniciativa qytetare, ju faleminderit për ftesën, desha vetëm të ju drejtohem juve zonja udhëheqëse se ligjet deri më tash kemi prodhuar ligje e ligje bukur shumë, por në zbatimin e tyre nuk e di edhe sa kohë ju duhet. Edhe deputetët e Parlamentit, por edhe të gjithë mbikëqyrësit t'i zbatojmë se ne e dimë fort mirë që konsumatori nuk është i mbrojtur. Që 18 vite konsumatori asnjëherë ndoshta ligji u qit, u shkrua mirë, por edhe ky draft ligj ndoshta do të jetë i mirë por në implementim është i çaluar, dhe duhet të ketë kontroll të duhur.

Ne e dimë fort mirë se 18 vite çfarë ... të dyshimta kanë ardhur dhe gjithmonë ligji e mbron, ligji nuk po e mbron konsumatorin, asnjëherë. Ne e dimë fort mirë, edhe me aditiv sa aditivi ka ardhur fort mirë, edhe mishi jo tash në vitin 2017-2018, por që 18 vjet konsumatori asnjëherë dashta po dal pak nga tema por asnjëherë konsumatori nuk ka qenë i mbrojturi. Mos ndoshta dhe ky ligj do të jetë më i mirë se ligji i mëparshëm, por duhet të jetë një kontroll e mirë dhe duhet ta dhëmë kontributin të gjithë që ta implementojmë ligjin. Se ne mund të ulemi këtu në tryezë të bisedojmë, të debtojmë dhe e qesim në letër, por në zbatim asnjëherë jo. Kështu që të kujdesemi pak se tha edhe zotëriu pak ne në Kosovë shumë ligje, bile as Gjermanisë ia mujm ndoshta. Zotëria është këtu më mirë i dinë këto, po këtu në implementim jo.Faleminderit!

NIJAZI SHALA: Nijazi Shala, Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit ... respekt po flasim për Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit. Domethënë është aq e thjeshtë, nuk është infrastruktura e cilësisë është thjeshtë relacionet tregtare, në relacion me produkte dhe shërbime. Fusha e mbrojtjes së konsumatorit rrokë shumë horizontalisht me këtë rast e kemi shumë specifike rastet para kontraktuale edhe kontraktuale në relacion me garancionin edhe kontratën. Ky ligj ...

KRYESUESJA: Unë veç kisha shtuar edhe diçka tjetër që mos të presim që Ligji për mbrojtjen e konsumatorit me mrekulli ose me magji ka me i rregullu dhe me e mbrojt konsumatorin. Ato raste, të cilat i përmendët në veçanti çështjen e mishit ose shkeljet tjera, ato më nuk përkojnë me këtë ligj, shkojnë me Kodin Penal të Kosovë se aty kemi të bëjmë me mashtrim edhe kemi të bëjmë me çështje, të cilat shkojnë përtej vetëm një ligji për mbrojtjen e konsumatorit.

Normal që drejtpërdrejtë janë konsumatorët ata që janë dëmtuar, por procesi i përcjelljes mandej nuk rregullohet në këtë ligj, se ai veç ka kaluar në fazën e shkeljeve penale, të cilat i takojnë jo

ministrisë ose deputetëve por Prokurorisë. Domethënë që ta keni të qartë për rastet të cilat në mundemi me i evidentua, por mandej procedura e vënies së drejtësisë ose mbrojtjes së interesave edhe kisha thënë që në momentin kur ka pas vetëdije dhe kur ka pas mobilizim qytetari nuk isha pajtuar që në 18 vitet e fundit s'ka ndodh asnjëherë konsumatori me u mbrojt. Mendoj që ka mjaftueshëm raste në periudhën e Kosovës pasluftës, ku me një mobilizim qoftë të shoqërisë civile, qoftë në ngritje të vetëdijes, kemi edhe rastin e fundit edhe pse me ligjin e vjetër ministria ka kthyer përgjigje që nuk rregullohen çështjet e energjisë, domethënë faturimet që janë bërë për rrymën në Veri, prapë një mënyrë janë prek drejtpërdrejtë qytetarët, konsumatorët e energjisë dhe është kthyer ose është ndërprerë ajo procedurë. Domethënë, funksionon në momente kur gjenden mënyrat edhe të ngritjes së vetëdijes, por edhe kërkimit të drejtësisë në institucionet relevante.

Vetëm unë prapë po e them e shoh si kritike për funksionim të mirëfilltë të ligjit informimi i drejtë i konsumatorëve për të drejtat e tyre. Mbas miratimit të ligjit, fushata vetëdijësuese që duhet me u organizua konsideroj prej Ministrisë së Tregtisë, Industrisë dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile do të jetë substanciale në rast se do të dimë se sa ky ligj mundet ose është në funksion të implementimit. Prej informacionit për produktin, për shërbimin deri te realizimi ose marrja edhe pas shërbimi pas marrjes ose pas blerjes të gjitha elementet ose pjesë të cilat ne si shoqëri i kemi të reja, pra nuk jemi mësuar në sistemin monist tash duhet gradualisht. Tjetër?

LIRIDON GASHI: Liridon Gashi, prej organizatës SEEF. I kemi disa vërejte të themi ashtu konkrete, për shembull te neni 2 thotë ky ligj është i zbatueshëm për çdo konsumator rezident në Republikën e Kosovës. Ne konsiderojmë që kjo “rezident” duhet me u largua, e çka me ata jo rezident, domethënë janë jashtë fushës së veprimit, si e para. E dyta, te neni 5, te përgjegjësitë e konsumatorit ndër tjerash thuhet “konsumatori duhet të jetë i vëmendshëm në vazhdimësi çfarë produktesh blen ose konsumon”. Po mendoj që kjo është jashtë mundësisë së konsumatorit me u kujdes edhe se si nen i ligjit konsideroj që kishte me ju dhënë shumë hapësirë tregtarëve me e shfrytëzua këtë ligj në shpinë- kurriz të konsumatorëve për mos kujdese, në rast neni konkret të këtij ligji.

Pastaj te neni 13, pika 2, te përcjellja e mesazheve publike reklamuese nga telefonia mobile dhe posta elektronike, thotë duhet të ketë ... mesazhit për mundësinë e anulimit të abonimit, kjo nuk ekziston as te telefonia mobile, në këtë rast përveç mos ekzistimit të anulimit është edhe shkelja e privatësisë ku ne shpesh marrim mesazhe në telefonat tonë edhe në e-mail edhe nuk e dimë prej nga i kanë marrë këto informata tona që janë personale. Pastaj, te neni 15, mbrojtja e posaçme për të miturit. Te pika 1 dhe 2, ku po e parafrazoj “ndalohet shitja e shërbimit... shitja dhe blerja e pijeve alkoolike, të futet edhe duhani. Domethënë, të mos shitet, shërbehet, konsumohet pijet alkoolike dhe duhani. Pastaj, të shtohet edhe pika 3, shembull të vendoset tiketa informuese në çdo market, kiosk, biznes që nuk shitet alkool dhe duhan për personat ndër moshën 18 vjeçare.

Po ashtu, si pikë e 4, të nenit 15 të shtohet edhe ndalohet reklamimi, billboarda edhe jashtë objekteve tregtare i pijeve alkoolike dhe duhanit në distancë 300-500m në afërsi të institucioneve arsimore, se shpesh e shohim nëpër statistika të institutit kombëtar të shëndetit publik që diku rreth 60% e të rinjve duke qenë nën moshën 18 vjeçare janë konsumues të duhanit dhe shume shpesh e vërejmë që në afërsi të shkollave ose ngjitur me shkollë ka kiosqe të tilla që shesin duhan, madje kanë edhe reklama për duhanin.

Po ashtu, mendojmë që tek neni 17, të shtohet edhe pika e 5 të bëhet subvencionim prej Qeverisë, Komunës që tregtarët të përdorin materiale të riciklueshme... për shembull, të përdoren qeset që njihen tek ne, qeset e letrës të cilat kishin me qenë sigurisht edhe me pagesë, por që kishin ndikuar shumë në uljen e deponive domethënë, sasisë së deponive. Pastaj, tek neni 137, te pika 1.1. shuma e ndëshkueshme për tregtarët prej 1 mijë deri në 10 mijë euro, e këto kundër shkohet në këtë pjesë edhe shitja, edhe shërbimi i pijeve alkoolike, siç e ceka më herët të shtohet edhe duhani është për shembull dënimi 1 mijë deri në 10 mijë euro, ndërsa për marrje të mesazheve neni 138, pika 1 është shuma 1 mijë e 500 deri 20 mijë euro për shembull, për vënie të reklamës në shtëpi, në vende të pacaktuara dhe vënie të panove ose fletave reklamuese në vetura. Me i shit të rinjve nën moshën 18 vjeçare dënimi maksimal 10 mijë euro, ndërsa me ua vu reklamën në automjetin e tij 20 mijë euro, konsideroj që kjo është një disbalanc shumë i madh edhe tek ndëshkimi për duhanin edhe pijet alkoolike të përdoren dënimet më të larta të mundshme. Këto janë pak a shumë ato që i kemi.

KRYESUESJA: Faleminderit, Liridon! Konsideroj që kontribut shumë me vlerë. Dikush tjetër? Po!

BUJAR MEKA: Përshëndetje për të gjithë, jam Bujar Meka e përfaqësoj Bankën Qendrore, po flas pak më tepër se fokusi kryesor i joni ka qenë te shërbimet financiare. Megjithatë, si anëtarë i grupit punues po flas edhe për pjesët që i ngriti edhe zoti prej SEFF, është e vërtetë që tash thuaj 2 vite bëhen kur kemi filluar me bë këtë draft ligj, edhe nganjëherë edhe po heziton njeri me marr fjalën për arsye se ka mundur diçka edhe mu harruar, para dy viteve në vazhdimësi që kemi punuar në këtë pjesë.

Çka di me thënë është se nenet ose dispozitat mos me u marr në kontest e para, për shembull te neni 5. Neni 138 ke për personat juridik jo për personat, e dyta, është se parim krejt puna e grupit punues ka qenë e mbështetur në direktiva të BE-së. Pra, nëse thotë neni 5 duhet me qenë i vetëdijshëm, kurrgjë nuk i bën keq nëse edhe konsumatori duhet me marrë gjithçka që mundet patjetër me ndikua në shëndetin e vetë ose është një lloj si me thënë me ua tërëhjek vëmendjen edhe konsumatorit. Megjithatë, bazë për hartimin e këtij draft ligji kanë qenë direktivat, qoftë për pjesët që nuk janë në shërbimet financiare, qoftë për shërbimet financiare që kanë qenë kredi konsumatore ose shërbime financiare në distancë.

Për atë arsye ne mundemi me diskutua edhe është mirë që po ngritën këto, po duhet mos me i nxjerr prej kontekstit dispozitat po me e lexua deri në fund me vëmendje edhe e dyta nëse janë kështu si janë, janë të harmonizuara me direktivat e BE-së, respektivisht direktivat e BE-së janë transpozuar besoj në masën më të madhe 99% janë transpozuar në këtë ligj. E kemi pas shumë diskutime, shumë edhe nganjëherë edhe mos pajtime në mënyrë sepse nuk është se çdo gjë e Bashkimit Evropian na përshtatet në kushtet dhe rrethanat që i kemi, por megjithatë duke ... drejt proceseve integruese të Bashkimit Evropian kemi pa të udhës që kështu është forma më e mirë, natyrisht që ka mundësi me e përmirësua tu e pas parasysh që tash kanë kaluar më shumë se 2 vite që nuk është se kemi punuar përditë, nganjëherë kanë ikë e kemi pas shumë shikëputje edhe ka mundësi që diçka ka ik. Përveç kësaj kemi konsultuar edhe ekspertë shumë eminent prej Kroacisë që ka qenë ai Marko ... ndër ekspertët e fushës të mbrojtës së konsumatorëve më eminent, gjithashtu edhe prej Malit të Zi eksperti që ka qenë rezident këtu, besoj që në parim ky ligj në asnjë rrethanë nuk është në kundërshtim me direktivat e BE-së. A janë të përshtatshme për realitetin e Kosovës mundemi me diskutua. Faleminderit!

NIJAZI SHALA: Jo, për këtë pikat që i ceku është interesant që pikat që nuk janë me direktiva të BE-së, realisht bazë e projektligjit është ligji aktual, propozimet prej punës adhoc sikur rasti, ose direktivat shumica prej këtyre, ndoshta 70-80% po përpos pikës 2, tjerat nuk janë me direktivat, këto çka i preke neni 5, 13, 15, 17 edhe 137, këto realisht mundemi me i intervenua përpos te pika 2, është me direktiva të BE-së. Qëndroj asaj çka thotë Bujari në këtë rast, por pikat i preku ato që nuk janë kështu që mundemi të ndërhyrë në qoftë se mendojmë se është e arsyeshme, mendoj.

GANI DRESHAJ: Unë po mendoj që shumë mirë që po diskutojmë, nuk shteret diskutimi kurrë, gjithmonë jemi në presionin e kohës, por do gjëra që unë i dëgjova sot më pëlqyen dhe si deputet unë jam i ri në këtë fazën ndoshta edhe s'jam profesionalisht i shkolluar për me qenë politikan por unë po mundohem gjithmonë me kon në anën e konsumatorit dhe sindikatës. Kam një kënaqësi të veçantë sot se edhe në televizion e kam ... kam kënaqësinë e veçantë me këto dy zonjat deputete, që janë duke punuar. Besoni në Zotin, se ky grup është duke punuar, doket jashtëpartiak, jemi tu u mundu me e ba gjithë më të mirën për konsumatorin edhe për me e mbrojt ligjin.

Pata edhe kënaqësi të veçantë me e njoftua dikë të Bankës Qendrore, i cili po përpiket këtu pak neve të na gjuajë pak pluhur syve. Unë ju kisha lutur Bankës Qendrore që me i thirrë të gjitha bankat komerciale edhe me ju thënë bankave komerciale që mbrojtja e konsumatorit bëhet nëse një njeri i bankës nuk i jep të dhënat bankare një tjetër konsumatori. Javën e kaluar më ka thënë një biznesmen, që të ka ardhur rata për t'u paguar, kredi që ke deri të hënën në mos e pagofsh të mbyllet. Domethënë, aty nuk është mbrojtur konsumatori.

Tjetër gjë, që e kam përmend në disa takime me banka ka qenë që të vjen me SMS që të kanë ardhur para në konto. Ban vaki që unë s'i kam treguar gruas time që kanë me më ardhë para, ose ia qon edhe gruas. Ana tjetër është që ju si bankë nuk i kryeni detyrat e juaja, se ta jep i njëjti person edhe kartelën edhe pin-kodin. Mua më është keqpërdorur karta prej njerëzve të bankës. Nuk është hetuar në Kosovë. Kjo është ai rojtari i ligjit, që s'jemi tu e ba. Na kemi një zotni atje që e ndjek ligjin është për krime ekonomike, që nuk e di as çka është pini, as çka është banka edhe s'e ka lexuar ndoshta as ligjin. Kështu që, çdo organ, çdo njeri që po i mbajmë edhe gjithë këto organizata është mirë neve të na gjuajnë në tavolinë punët prej posaçërisht ku e prekun qatë laminë e tij. Mua më duket që kemi njerëz edhe zotëriu nga ministria nuk është kurrkush që mos me ec përpara. Që po na duhet më shpejt, po edhe ma konkret, se nganjëherë po mërzhitemi me i thënë njëri-tjetrit, si unë Bujarit që po i drejtohem, këto i kam problemet që i kam ndi, nuk është normale me të ardh, me ta dhënë një njeri edhe kartelën edhe pinin, edhe me ta ditë pinin, edhe me ta ditë xhiro-llogarinë edhe me të dalë ato të dhëna jashtë, edhe me të kalua nëpër SMS, se t'i nxen ai në postë. Ne po e dimë që s'kemi të mbikëqyrur.

Nuk është normale dhe e kam sot personalisht kam prek që unë deklaroj pasurinë, po edhe ma lexon gjithkush. Mua më del ajo në faqe, nëse deklarimi i pasurisë për antikorrupsion, atëherë duhet me e ditë organet, po nëse mua më del në internet unë s'guxoj me dalë përtej shtëpisë time, ose fëmija im s'guxon me dalë. Ashtu s'mbrohet qytetari, as konsumatori. Ne po mundohemi të jemi transparentë, por ka gjëra që ke nevojë, atëherë janë organet përkatëse, që do të përcjellin, se ju shurdhova edhe unë, po ndoshta ne diaspora kemi qejf edhe shumë me fol, na merr malli, veç më mirë është më konkret me qenë.

BUJAR MEKA: Më duhet, pa dashur të replikoj, po nuk tentova asnjë rast të ju qes hi syve, se s'ke diçka pos çka ka bërë grupi punues desha ta shpjegoj. Këtë pjesën tjetër, sa i përket Bankës Qendrore, besoj që Banka Qendrore ushtron rolin e saj konform kompetencave dhe përgjegjësi që i ka, qoftë në Kushtetutë, qoftë edhe në Ligjin për Bankën Qendrore. Edhe është shumë aktive në mbrojtjen e konsumatorëve, ka një bashkëpunim të jashtëzakonshëm edhe me bankat edhe me shoqatën e bankave, por në asnjë rast nuk lejohet që banka me i shkelë rregulloret ose legjislacionin në fuqi, në bazë të të cilit ato edhe funksionojnë.

Sa u përket pineve, sa u përket atyre, çdo gjë është në kontratë. Unë e kam një përshtypje... kontratat të lexohen, s'e di sa lexohen. Nuk ka asnjë rast, se këto trajtohen në Bankë Qendrore, kemi ankesa përditë, por nuk ka asnjë rast që ne i themi Bankës çfarë ke bërë në këtë rast që nuk ta dokumenton, që më së pari, para se me u bë vetëm anëtar klient i bankës, i ke një serë informacionesh parakontraktore, pa hyrë në marrëdhënie obliguese, që të sqarohet çdo detaj. Pasi të hysh në marrëdhënie kontraktuese, marrëveshje kontraktuale, prapë në asnjë rast nuk ka mundësi që gjërat, jo SMS-i, jo këto... pa t'u përmbajtë bazës në kontratë që e nënshkruan klienti me bankën. Për çdo ankesë që është paraqitur në Bankë Qendrore, Banka Qendrore ka qenë shumë aktive, kemi marrë edhe masa të jashtëzakonshme që ka qenë ndoshta lajm top-lajm në

Kosovë, rreth çështje të mbrojtjes së konsumatorit. S'besoj që e ka bërë asnjë institucion tjetër, qoftë i pavarur apo i linjave.

Nuk e di ku mund ta marrim ndonjë shembull, ato mund të jenë sikur kjo çështja që po e ngrini ju, por megjithatë bazën e kanë të rregulluar. Bazën e kanë të rregulluar Banka Qendrore për shkak të rritjes së kapaciteteve të saj ka më shumë se 500 ankesa brenda vitit i trajton. Ankesa informacione, ose çkado që janë shqetësime të qytetarëve, s'domethënë se të gjitha janë me të drejtë të qytetarëve, por është shumë aktive që në asnjë rrethanë mos me e përjashtua qytetarin, ose klientin nga informimi për shërbimet, ose pranimin e shërbimeve financiare, që e bën.

GANI DRESHAJ: Bujar, më fal se për ato "për pluhur syve" po them, po ne nëse ulemi e diskutojmë këtu, se edhe unë në fillim i kam marrë të gjitha personale, nuk ishte personale me ty. Më fal, se ajo ishte... prapëseprapë, edhe dy orë me fol mundesh shumë i informuar jam kah çështja e bankave. Edhe që shkeli për çdo ditë edhe që janë 500 kontrolla të bankës në vit, nuk është ndonjë lavdatë. Të lutem, s'është lavdatë, se edhe ju keni probleme aq sa Banka Qendrore ishte dashur 500 në ditë me i pas.

BUJAR MEKA : Jo, jo veç është... nuk është fjalë e mirë me thënë e shkeli ligjin, se nuk e shkeli ligjin. Në asnjë rast nuk shkelet ligji, sidomos nga Banka Qendrore, nuk ka pse. E dyta, ne jemi duke i mbikëqyrë ose duke i rregullu institucionet financiare. E kemi një qasje shumë konservative, për çdo gjë mundohemi me i pas në kontroll maksimalisht, që në fund të fundit të përfitojë qytetari. Ka edhe banka, duhet me i pa edhe në sektorë tjerë, duhet me i pa edhe partneritet në zhvillim. Jo çdo gjë edhe me ju gjuajt veç bankave, ose kompanie...

GANI DRESHAJ: Kur ka bë Banka Qendrore e Kosovës rejting të vlerësimeve, pasi që jemi duke i mbrojtur konsumatorët. Çfarë vlerësime kemi të pagesave të krediteve të performancave, pasi i paskët bërë kaq shumë.

BUJAR MEKA: Sot Kosova është vendi me performanca e kredive më të ulëta në rajon, për shkak të një kontrolli për shkak të qasjes së Bankës Qendrore ndaj bankave. E kemi stabil një sistem financiar shumë stabil. Nuk e di çfarë lloj rejtingu tjetër duhet me pas, ose për çfarë lloj reitingu e ke fjalën.

GANI DRESHAJ: OK unë po mendoj që rejtingu është nëse është aq stabil atëherë ish dashtë me qenë për qindja ish dashtë me shku mbasi është pagesa më e mira në Ballkan, ishte dashtë me ...

BUJAR MEKA: Besoj që jemi në rajon jemi krahasuar në rajon me çfarëdo rrethanash.

KRYESUESJA: Mundem diçka që t'i ndajmë çështjet. E kuptoj edhe reagimin e zotit Dreshaj dhe Bujar, duhesh një gjë ta kemi parasysh.

Shkeljet e ligjit, në këtë rast Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, ne jemi të gjithë të vetëdijshëm që ndodhin. Ndodhin në aspekte të ndryshme. Tash, në aspektin institucional të raportimeve në sistemin e shërbimeve financiare, mund të themi se përgjithësisht duket mirë, po në shumicën e rasteve tarifat e fshehta, ose tarifat për të cilat nuk informohen konsumatorët, janë ato të cilat më së shpeshti ndodhin, prej më të thjeshtave, nuk po flasim për informacione, rrjedhjen e informacioneve, ligjin... mbrojtjen e të dhënave personale e të tjera, por informacioni mbi secilën tarifë, qoftë edhe më e ulëta, ose më e vogla, në transaksionet financiare, konsideroj se është obligim i secilit institucion financiar. Kjo është elementi më i shpeshtë që ndodhë, pra nuk ndodh vetëm në institucionet financiare, ndodh edhe në institucionet publike, ndodh edhe në ministri, në Ministrinë e Punëve të Brendshme të lëshimi i dokumenteve. Nëse t'i ndalin 50 centë nuk i ke të lajmëruara, nëse shikohen informacionet mbi koston e nxjerrjes së letërnjoftimit, pasaportës e të tjerave, kur shkon aty e merr vesh se e ke gjysmë euro më shtrenjtë, një euro më shtrenjtë aty... Domethënë, kjo është një qasje holistike, ose e përgjithshme, që si institucion në raport me funksionimin e këtij ligji duhet me i ndërmarrë. Edhe secili nëpunës, qoftë i institucionit privat, qoftë i institucionit publik duhet me ditë që secili qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtën e informimit për ato tarifa, sado që të jenë ato. E, tek bankat ndodhë ndoshta pak më shpesh, për shkak të shpeshësisë së transaksioneve e punëve që njerëzit i kanë me sistemin bankar.

BUJAR MEKA: Më falni, se ndoshta po flas shumë, po më duket më ndryshe, veç një gjë po dua ta them. Besoni se krejt këto janë të rregulluara në mënyrë detaje. Është rregullorja për shpallje të normës së efektivit të interesit dhe çdo lloj shpallje tjetër, çdo gjë, qoftë edhe për 50 centë, banka duhet ta ketë tarifën përpara. Sa i lexojmë ne, sa ka mundësi..., se e kemi, po edhe veç edhe ... bëhen në këtë rast, të kemi pak edhe kulturën, pak edhe juridike edhe...

SHERIF FEJZULLAHU: Nëse më lejoni pak në rolin e ndërmjetësuesit jam.

Shiko, zoti Bujar, unë jam pak në anën e deputetit, jam edhe qytetar edhe konsumator, po ta them të drejtën, për çka po pajtohem me ju? ka shumë avancim në çështjen e administratës, rregullave, pritjeve... por, nuk do të thotë që nuk ka edhe mangësi. Unë i përjetoj edhe vet si deputet. Sekretet jepen. Përpara kanë punuar pesë sportela derisa e rrasën popullin në kredi, tash kur të shkosh është një e presin 30 vetë aty, vonohen në punë...

Domethënë, ne jemi, jo me qëllim, ne jemi për ta plotësuar atë vakum e atë mungesë, e cila duhet, mos e merr për zemër atë, Banka ka përparuar shumë, por kur i themi Banka Qendrore, ju mbuloni të gjitha bankat që i keni në nivel të komunave. Për atë arsye, aty ku ka mangësi ju lutem të intervenoni. Ka të drejtë deputeti, nëse sekretet dalin dhe atëherë kriminelët janë të gatshëm, me adresë të saktë me intervenua. Kështu që, mos e merr për zemër. Ka shumë avancim, po ka edhe dobësi, në kamata e në diçka që konsumatori nuk e di. Mos t'i marrim personale. Unë vet kam intervenuar. Kur i shoh aty, dalin për gjysmë ore të paguajnë 30 veta një shallter. Unë jam pak si ku është shefi këtu? Pastaj vijnë dy-tre përnjëherë. Ju lutem, keni

konsideratë. Njerëzit dalin për gjysmë ore me ta kryer punën, aty punon një shallter, nuk ka mundësi, kështu që në qatë kuptim, nëse keni mundësi të intervenoni.

BUJAR MEKA: A ka mundësi ta shtysh një biznes privat me i mbajt pesë sportelistë? Nuk ka mundësi, se është biznes privat, një. E dyta, zhvillimet teknologjike kanë avancuar, shumë sende kryhen online.

KRYESUESJA: Ju lutem ta mbajmë diskutimin të fokusuar në kuadër të projektligjit. Saktësisht, është edhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ato nuk rrjedhin veç prej bankave, rrjedhin edhe prej doktorëve, e prej... ordinancave, atë e keni kështu... po, kështu që është edhe ai elementi edhe social e kulturor pak. Po, urdhëro!

ILIR GAXHA: Jam Ilir Gaxha, sot në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës së Bankave, jam kryesues i Departamentit Ligjor në njërin prej bankave.

Më lejoni të theksoj që si sektor bankar jemi ndoshta më të avancuarit edhe me zbatim të rregullave, njëkohësisht jemi edhe nën institucionet që jemi të mbikëqyrur në mënyrën më strikte të mundshme prej Bankës Qendrore. Pavarësisht rrethanave, domethënë çdo qytetar siç e përmendi edhe më herët parafolësi, vjen i nënshkruan marrëveshjet, nuk i lexojnë. Sa prej jush i keni lexuar?

Ne ua shpjegojmë çdo gjë, sa u përket çmimoreve në secilën degë janë tepër të mëdha të reflektuara ndoshta edhe më të mëdha se sa ky monitor këtu që po shohim, në sipërfaqe çdo çmim për secilin shërbim që ofrohet. Sa u përket ankesave qytetarët kanë të drejtë të bëjnë ankesa në bankë, me e shterë atë, banka i udhëzon të shkojnë të ankohen në bankë qendrore, banka i udhëzon të shkojnë në gjykatë nëse mendojnë se kanë të drejtë. Sa u përket shërbimeve me SMS, krejt çka duhet nëse ekziston ai shërbim të kërkohet prej bankës që të mos ofrohet më. Janë klientët që i kërkojnë shërbimet, janë klientët ata që mund t'i ndërpresin në cilëndo fazë.

KRYESUESJA: Më fal, zoti Gaxha, a ke konkretisht diçka për projektligjin? E kuptoj poentën e juaj por, vetëm ta keni parasysh, ne e kemi edhe një seancë të jashtëzakonshme në ora 2, që është thirrur, kështu që po dua t'i dëgjojmë të gjitha komentet në raport me projektligjin, në mënyrë që të gjithë të ndihen që i kanë raportuar, ose dorëzuar në komision komentet e tyre.

ILIR GAXHA: Sa i përket projektligjit, qasja e Bankës Qendrore dhe e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me bankat ka qenë gjithmonë për t'u ofruar shërbime sa më të mira qytetarëve për të qenë sa më të njoftuar qytetarët për shërbimet që i marrin dhe përjashtimet që kanë ekzistuar në ligjin e kaluar. Të tri palët në bashkëpunim kemi shikuar t'i minimizojmë për të shkuar në favor të klientëve. Domethënë, ka qenë edhe vullneti i bankave e aq më shumë i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë e po ashtu, edhe i Shoqatës së Bankave.

Pak më herët u përmend disa herë që është marrë parasysh jo vetëm direktiva dhe ligji i kaluar, por praktikat. Çfarëdo telashesh që kemi hasur me zbatimin, së paku prej aspektit të bankave, se nuk mund të flas për sektorët tjerë, ne i kemi marrë parasysh dhe i kemi adresuar. Mua më vjen mirë që në grup punues janë marrë parasysh të gjitha shqetësimet, për shkak se fillimisht është menduar të bëhet një draft, ku kanë qenë disa kërkesa teknikisht të porealizueshme. Edhe arsyetimi prej bankave, edhe Bankës Qendrore, tek ministria, tek grupi punues, është bazuar në atë se sa janë teknikisht të realizueshme, me e dëshmuar qëllimin e mirë të krejt sektorit bankar, për ta bërë një ligj që do të shkojë në favor të qytetarëve.

Krejt në fund do të thosha që bankat janë transparente, do të bashkëpunojnë deri në fund, çfarëdo drejte ligjore nuk mund t'i mohohet askujt, përdërisa ekziston. Krejt qytetarët do të kenë të drejtë t'i ndjekin disa instanca ligjore që të mund ta gëzojnë të drejtën e vet. Faleminderit!

NIJAZI SHALA: Kur të flasim për vakum, mendoj se vakumi më së shumti që u plotësua është te kjo direktivë për kredi konsumuese. Teknikisht të porealizueshme, kjo është 100% direktiva. Realisht, prej juve i kemi marrë 40 komente, saktësisht 39 komente. Faleminderit!

KRYESUESJA: A ke komente tjera? Po, deputetja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Unë kërkoj falje se erdha pak me vonesë, ndoshta disa prej gjërave edhe i keni diskutuar.

Përshëndetje për të pranishmit!

Kam lexuar një letër publike, nëse s'gaboju ka qenë letër publike e zotit Kaçaniku lidhur me parapagimin për RTK-në. Sigurisht, se e keni diskutuar, unë vetëm desha në fakt të inkurajoj edhe drejtorin e Departamentit për mbrojtjen e konsumatorit, por edhe të tjerët, që të involvoheni edhe në dëgjim publik po të kërkonin në fakt prej deputetëve të komisionit tjetër parlamentar, që ju të jeni pjesë e tij. Edhe unë mendoj si deputete, jam kundër, faktikisht që parapagimi për RTK-në të jetë pjesë e faturave të KEK-ut, sepse në këtë formë bëhet një pagesë e obligueshme dhe ndoshta për disa është një kanal që nuk dëshiron askush ta përcjellë, një kanal televiziv.

Tjetra, drejtor çka ka munguar prej Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka munguar komplet reagimi sa i përket shkeljes së ligjit dhe të të drejtave të konsumatorit të rasti i skandalit të pagesës së energjisë elektrike për 4 komunat veriore komplet. Nuk kemi pasur asnjë reagim, është dashur sigurisht që ju t'i tregoni ministrit, që ai të reagojë dhe të jetë edhe reagimi i tij, sepse edhe sot ne kemi përfaqësues të ZRE-së dhe institucioneve tjera që thonë se ka një masë të përkohshme të gjykatës, por nuk ka shkelje të ligjit dhe shkelje të të drejtave të konsumatorëve, kinse gjykata do e vendosë atë nëse është shkelje... Unë mendoj se është shkelje e rëndë, edhe e ligjit, edhe e të drejtave të konsumatorit, për shkak se konsumatorët kanë paguar për një produkt të cilin ata nuk e kanë shpenzuar, e ka shpenzuar dikush tjetër.

Meqenëse, kemi edhe kryesuesin e Bordit të Agjencisë Rregullative të Ujrave, e njëjta gjë po ndodh edhe me faturat e ujërave. Sigurisht, se ashtu kemi marrë informacione që ujësjellësi në Mitrovicë, atje në fakt raportin e ndërmarrjeve publike, që është dorëzuar Kuvendit i është thënë se ... po, ato domethënë kështu kanë qenë, humbje kanë qenë edhe ato derisa ne morëm vesh se kanë qenë të inkorporuara në fatura. Është e njëjta gjë. Domethënë, katër komunat veriore në fakt nuk paguajnë faturat e ujit edhe ato sigurisht nëse llogariten humbje edhe kompania subvencionohet prej shtetit, është pikërisht e njëjta gjë. Domethënë, këtë unë e pata.

Pash edhe përfaqësues të cilët nuk është se përfaqësojnë të drejtat e konsumatorëve, thjesht mund të vijne këtu dhe të llobojnë për interesa të veta, siç ishte ulur aty më herët, nuk e di nëse e ka pasur fjalën Jakup Gashi, që është pronar i laboratorit të naftës dhe ai kërkon me e kontrollua secilën litër të naftës, kinse për t'i mbrojtur të drejtat e konsumatorit, por në fakt nuk është ajo mbrojtje e të drejtave të konsumatorit. Ajo është lobim për një biznes të vetin personal.

Ne ligjin e kemi në mes të dy leximeve dhe do të mundohemi që faktikisht t'i marrim këto komentet e juaja. Unë nuk jam pjesë e grupit punues, por megjithatë jam në këtë komision funksional, që ligji të bëhet i respektueshëm. Nuk është krejt përgjegjësia e ministrisë për implementim të këtij ligji. Ju e dini, aty mbledhen të dhënat dhe distribuohen ankesat diku tjetër. Kështu që, unë kaq pata. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Bajrami! Po!

RAIF PRETENI: Faleminderit, kryesuese!

E nderuara deputete,

Unë s'po dua të ju marr kohë, për arsye se para tri ditësh kam dorëzuar raportin për Kuvendin, ku specifikisht diku janë tri faqe për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, është një raport i Auditorit të Përgjithshëm, raporti vjetor për vitin 2017, ku është interesuar rreth veriut dhe furnizimit me ujë... të avokatit të popullit, më falni. Edhe ai ka konstatuar se nuk ka lidhje uji me veriun me shpenzimet e ujësjellësit tjetër. ato shpenzime, sikur në rastin e energjisë që paguan ministria, respektivisht Qeveria e Kosovës, mirëpo kjo pjesa në tarifa të pjesës tjetër për veriun dhe jugun e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt nuk kanë lidhje me tarifa. Ne e kemi caktuar një çmim. I kemi thënë kompanisë në Mitrovicë, që ju lidhni kontratë me atë pjesë, kush i paguan është çështje e Qeverisë, po ngarkesë absolut nuk kanë lidhje, sikur te rasti i energjisë.

KRYESUESJA: Po, zoti Kaçaniku, pastaj Njaziu dhe po i përmbylim.

SELATIN KAÇANIKU: Kam konsideratë për kohën, prandaj e shkurtova këtë, por po dua të inkuadrohem.

Zoti Preteni tha se do t'i paguajë Qeveria, ose i ka paguar Qeveria. Cila Qeveri?

Ne jemi qytetarë konsumatorë, taksapagues, gjenerues kryesorë të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Në çdo variant ne i paguajmë! Në çdo variant ne i paguajmë, prandaj pak transparencë, pak llogaridhënie, t'i ndajmë përgjegjësitë, pak respekt ndaj nesh! Ne ua japim votën, ne u japim para! Ne e kemi formuar shtetin, por kur duhet marrë votën e për t'i marrë paratë të gjithë na respektoni, kur duhet me u marrë vesh për votën dhe me dorëzimin e parasë ... frymë! S'është asnjë. Po, hajde more ne gjejmë na të mirë për votë, edhe s'jemi të mirë për para, por ne jemi të mirë edhe më tutje. Domethënë, qarku i bashkëpunimit, i partneritetit, po mbetet i hapur. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Po!

NIJAZI SHALA: Shumë shkurt. Veç për punën e ... që e ngriti çështjen ish-ministrja. Puna e energjisë elektrike dhe puna e ujit janë adresuar te Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit nga Avokati i Popullit, jo nga konsumatori, si shqetësim e kemi drejtuar te Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit. Janë dalë me rekomandim për punën e energjisë, por jo për punën e ujit, për vetë faktin si ka qenë e shprehur. Por, si çështje janë ngritur, janë ngritur dhe adresuar prej këshillit.

KRYESUESJA: Faleminderit! E kemi të qartë. Raporti është dorëzuar. Unë tregova, e kemi parë, e kemi diskutuar edhe në Kuvendin e Republikës. Ato janë humbje. Zoti Kaçaniku ka të drejtë, i paguajnë qytetarët e Republikës së Kosovës, por është çështje politike shumë e gjatë. Përmes buxhetit të Qeverisë, jo përmes konsumatorit, siç ka qenë rasti me tarifimin përmes Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, domethënë ka shkuar në një... shkon në një sistem tjetër, të paktën çështja e ujit për komunat e veriut.

Unë të gjithëve dua të ju falënderoj për prezencën, për kontributin!

Gjithashtu, edhe një herë më lejoni t'ua rikujtoj në fund, që të gjitha komentet me shkrim që ju mendoni t'ia dorëzoni grupit punues, sekretarisë së Komisionit ia përcillni deri të premtën. Mund t'i merrni informacionet nëse doni në formë elektronike, ose në formën e shkruar dhe të dorëzuar këtu.

Gjithashtu, sekretaria e Kuvendit e ka listën e pjesëmarrësve sot. Kush është i interesuar të marrë pjesë në punën e grupit punues, domethënë në mes dy leximeve, të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, jeni të mirëseardhur. Ne duam që projektligji të jetë në formë sa më i kompletuar dhe të merren parasysh të gjitha brengat, idetë dhe kontributet që mund të bëhen në këtë fazë. Gjithashtu, ju siguroj se puna e komisionit do të vazhdojë e pa ndalur, domethënë se nuk do të ketë vonesa në procedim të mëtutjeshëm të projektligjit.

Deri në takimin e radhës ju falënderoj shumë dhe ju uroj një kohë të mirë dhe sa më tepër bashkëpunim të mirë!